

Kosova: Letërsia metatekstuale

Vehbi Miftari

Përmbledhje

Objekti i tekstit *Kosova: Letërsia metatekstuale* është kritika letrare e zhvilluar në Kosovë, si pjesë e kritikës letrare shqipe dhe, më tej, e letërsisë shqipe përgjithësisht. Prandaj, përcaktuesi ambiantal “Kosovë” nuk synon të prekë statusin e letërsisë shqipe, sa format e saj, duke i theksuar tiparet e përbashkëta, po aq sa edhe veçantitë e zhvillimit të saj.

Sikur dihet tashmë, konteksti në të cilin u zhvillua kritika letrare në Kosovë, sidomos gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, është i ndryshëm nga kontekstualiteti i kësaj letërsie në Shqipëri, megjithëse edhe ajo mbetet, deri nga fundi i viteve '60, e lidhur me të, sado në trajtë të zbutur. *Tekstualiteti* i saj, ndërkaq, prek tipa, forma e metoda, sikur edhe zhanre e diskurse të ndryshme. Ajo e njeh *kritikën akademike* e *kritikën e shkrimtarëve*, deri dhe *projektin kritik*, si forma të kritikës.

Kërkimi ynë këtu i njeh dhe i kërkon *modelet* dhe autorët përfaqësues, duke nënkuptuar me ta një numër tekstesh dhe autorësh.

Fjalët kyç: modeli himnizues, modeli kritik, vetëdija modern për kritikën, kontekstualiteti e tekstualiteti i kritikës, format dhe metodat, autorë e tekste themelore.